



Kolegji i Posaçëm i Apelimit zhvilloi më datë 23.04.2024, ora 10:00, seancën gjyqësore publike të çështjes me numër regjistri (JR) 42 – 17/ 2018, datë 11.04.2023, lidhur me kërkesën e ish – subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (JR) nr. 6, datë 28.02.2019.

Gjatë paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare, duke u qëndruar shkaqeve të ankimit të paraqitura gjatë seancës së datës 17.04.2023, Komisionerja Publike, përfundimisht, i kërkoi Kolegjit ndryshimin e vendimit nr. 42, datë 18.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të kërkueses Antoneta Sevdari.

Përfaqësuesja ligjore e kërkueses Antoneta Sevdari deklaroi se shkaqet e ankimit, bazuar në vlerësimin e GjEDNj-së janë joproporcionale për marrjen e masës disiplinore, referuar qëllimit legjitim të procesit të rivlerësimit. Sipas përfaqësueses ligjore, konkluzioni i GjEDNj-së është i detyrueshëm për zbatim dhe për këtë arsye, Komisionerit Publik i kanë rënë shkaqet e ankimit, sepse ato nuk mund të çojnë në marrjen e ndonjë mase disiplinore ndaj znj. Antoneta Sevdari.

^

Përfundimisht, znj. Antoneta Sevdari i kërkoi Kolegjit të zbatojë vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke lënë në fuqi vendimin nr. 42, datë 18.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi vlerësoi se ka arritur nivel të besueshëm në të trija kriteret e rivlerësimit.

Pasi dëgjoi konkluzionet përfundimtare të palëve, trupi gjykues vendosi të tërhiqet për marrjen e vendimit përfundimtar, të cilin do ta shpallë më datë 10.05.2024, ora 13:00.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.3. Tiranë.

POSTUAR NGA: NJOFTIME ([HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME/](https://kpa.al/category/njoftime/)), NJOFTIME
([HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME-SQ/](https://kpa.al/category/njoftime-sq/))

< Njoftim (<https://kpa.al/njoftim-1263/>)

